

# Vodafone TV – Deklarata e Privatësisë

Ky suplement privatësie jep disa informacione shtesë specifike për Vodafone TV dhe përpunimin që ne bëjmë kur shikoni televizor në dekoderin tuaj ose në aplikacionin Vodafone TV. Për informacion të përgjithshëm rreth mënyrës se si i përpunojmë të dhënat tuaja, duke përfshirë të dhënat që përpunojmë si pjesë e ofrimit të lidhjes me brez të gjerë (broadband) nëse keni blerë Vodafone TV si pjesë të një pakete, vizitoni [Rregulloren tonë të Privatësisë](#).

Përditësimi i fundit: Mars 2022

## Kush jemi ne

Ne jemi Vodafone Albania Sh.A. dhe jemi pjesë e grupit Vodafone Group Plc.

Në këtë politikë privatësie:

- “ne/neve” do të thotë Vodafone Albania Sh.A.
- “palë e tretë” nënkupton dikë që nuk jeni ju apo ne; dhe
- “Vodafone Group” nënkupton Vodafone Group Plc dhe çdo kompani apo organizatë tjetër në të cilën Vodafone Group Plc zotëron më shumë se 15% të kapitalit aksionar.

Adresa kryesore e ushtrimit të aktivitetit të Vodafone Albania është: Autostrada Tiranë-Durrës, Rr. “Pavarësia”, Nr. 61, Kashar, Tiranë, Shqipëri. Vodafone është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (identifikuar me numër NIPT K11715005L) si dhe si subjekt kontrollues pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (IDP), në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

## Si mund të na kontaktoni

Mendimi juaj ka rëndësi për ne – nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me politikën tonë të privatësisë, mund të na dërgoni email në: [alfunc.askprivacy@vodafone.com](mailto:alfunc.askprivacy@vodafone.com) ose mund t'i shkruani ekipit tonë të privatësisë në:

Skuadra e Privatësisë  
Vodafone Albania  
Autostrada Tiranë-Durrës  
Rr. “Pavarësia”, Nr. 61  
Kashar, Tiranë,  
Albania

## Informacioni personal që mbledhim për ju

### Informacioni që mbledhim për ju

Llojet e informacionit që ne përpunojmë për ju kur shikoni televizor në dekoderin tuaj ose përmes aplikacionit janë:

- Emri, adresa, data e lindjes dhe adresa e emailit tuaj;
- Informacionet tuaja kredenciale si fjalëkalimet, sugjerimet dhe informacione të ngjashme sigurie të përdorura për vërtetimin dhe aksesin në llogaritë dhe shërbimet;
- Informacioni i llogarisë suaj, si p.sh. plani televiziv të cilin keni dhe profilet e shikimit që keni vendosur;
- Historia juaj e shikimit dhe rekomandimet që ju tregojmë;
- Zakonet tuaja të shikimit (si p.sh. kur vendosni faqeshënues ose shtoni një shfaqje në listën tuaj të shfaqjeve të preferuara apo të dëshiruara për t'u parë në një tjetër moment);
- Informacioni për kujdesin ndaj klientit nëpërmjet kontaktit tuaj me ne, si p.sh. një shënim ose regjistrim i një telefonate që bëni në një nga qendrat tona të kontaktit;

- Informacion në lidhje me pajisjen tuaj celulare ose set top box. Për shembull, ne mbledhim informacion mbi llojin e pajisjes celulare që po përdorni dhe identifikuesin e saj unik të pajisjes (për shembull, numrin IMEI, numrin e telefonit celular të pajisjes ose adresën MAC të ndërfaqes së rrjetit me valë të pajisjes);
- Informacion në lidhje me përdorimin tuaj të Aplikacionit, si p.sh. sa shpesh e përdorni atë; dhe
- Të dhënat e vendndodhjes suaj. Kjo mund të jetë e saktë ku përdor të dhënat e Sistemit të Pozicionimit Global (GPS) ose duke identifikuar shtyllat e telefonit celular dhe hotspote Wi-Fi ku jeni duke parë TV në një pajisje celulare. Ose më pak të sakta ku, për shembull, një vendndodhje e marrë nga adresa juaj IP ose të dhëna të tilla si një kod postar ose emri i një qyteti.

Ne gjithashtu do të marrim informacione për mënyrën se si i përdorni produktet dhe shërbimet tona, si p.sh.:

- Niveli i shërbimit që merrni – për shembull, defekte në rrjet ose në shërbim dhe ngjarje të tjera që mund të ndikojnë në shërbimet tona të rrjetit ose shërbime të tjera;
- Detajet e përdorimit tuaj të shërbimeve tona – për shembull, cila përmbajtje kërkohet më shumë; dhe
- Ne mbledhim gjithashtu informacione anonime analitike se si klientët tanë përdorin aplikacionin Vodafone TV për të përmirësuar përvojën tuaj dhe për të zgjidhur problemet.

Kur mbledhim informacionin tuaj personal

Ne mbledhim informacionin tuaj personal kur:

- Ju së pari blini Vodafone TV;
- Kur shikoni ose blini përmbajtje të ofruara nga Vodafone TV ose përdorni aplikacionin Vodafone TV; ose
- Ju kontaktimi ekipin tonë të shërbimit të kujdesit ndaj klientit me një pyetje ose ankesë.

Vodafone do të përpunojë të dhënat tuaja personale bazuar në:

1. **Përbushjen e kontratës suaj ose për të lidhur kontratën** dhe për të marrë masa për kërkesat tuaja. Për shembull, ne përpunojmë informacionin e llogarisë tuaj dhe detajet e pagesës për faturimin mujor të shërbimit.
2. **Interesat legjitime të biznesit të Vodafone**, për shembull, parandalimi i mashtrimit, ruajtja e sigurisë së rrjetit dhe shërbimeve tona, marketingu i drejtpërdrejtë kur kemi pëlqimin tuaj për t'ju kontaktuar dhe përmirësimi i shërbimeve tona. Kurdoherë që ne mbështetemi në këtë bazë të ligjshme për të përpunuar të dhënat tuaja, ne vlerësojmë interesat tona të biznesit për t'u siguruar që ato të mos i tejkalojnë të drejtat tuaja. Për më tepër, në disa raste ju keni të drejtë të kundërshtoni këtë përpunim. Për më shumë informacion, vizitoni seksionin 'Të drejtat Tuaja' të kësaj politike.
3. **Pajtueshmërinë me një detyrim ligjor**, duke përfshirë për shembull kërkesat e kontabilitetit dhe tatimeve, të cilat janë subjekt i politikave strikte të brendshme (si periudhat e ruajtjes), procedurave dhe e drejta juaj për të kufizuar përdorimin e të dhënave tuaja, të cilat kontrollojnë fushën e ndihmës ligjore të sigurohet; ose
4. **Pëlqimi që jepni** kur Vodafone nuk mbështetet në një bazë tjetër ligjore. Pëlqimi ju paraqitet gjithmonë veçmas dhe ju mund ta tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo kohë.

## Si i përdorim të dhënat tuaja personale

Për t'ju ofruar shërbimin tuaj

Ne përdorim të dhënat tuaja për t'ju ofruar shërbimin që keni blerë, si p.sh.

- Shikimi, regjistrimi dhe aksesimi në përmbajtje;
- Blerja e përmbajtjes së mëtejshme; dhe
- Ofrimi i kujdesit ndaj klientit dhe zgjidhjes së problemeve.

Profilizimi dhe vendimmarrja e automatizuar

Ne kryejmë profilizimin e zakoneve tuaja të shikimit; këto të dhëna nuk përdoren për qëllime të tjera përveç rekomandimit të shfaqjeve dhe përmbajtjeve të tjera që mund të dëshironi të shikoni.

## Si i ndajmë të dhënat tuaja personale

Kur është e mundur, ne ndajmë informacione për ju me:

- Kompanitë në Grupin Vodafone;
- Partnerët, furnitorët ose agjentët e përfshirë në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve që keni porositur ose përdorur;
- Kompanitë që janë të angazhuara për të kryer shërbime për, ose në emër të Vodafone Limited, ose Vodafone Group;
- Agjencitë e referencës së kredisë, parandalimit të mashtrimit ose vlerësimit të biznesit, ose agjenci të tjera të vlerësimit të kredisë;
- Agjencitë e mbledhjes së borxhit ose organizata të tjera për rikuperimin e borxhit;
- Agjencitë e zbatimit të ligjit, organet qeveritare, organizatat rregullatore, gjykatat ose autoritete të tjera publike nëse duhet, ose jemi të autorizuar me ligj; ose
- Një palë ose organ i tretë ku një përhapje e tillë kërkohet për të përmbushur çdo ligj të zbatueshëm ose kërkesë tjetër ligjore ose rregullative.

Ne gjithashtu ndajmë informacionin e përgjithshëm të shikimit me partnerët e ofruesve të përmbajtjes për të kuptuar se sa e kërkuar është përmbajtja që u ofrohet klientëve tanë. Për shembull, nëse e dimë se shfaqje të caktuara janë popullore, ne do të fokusohemi në marrjen e përmbajtjeve të ngjashme për ju. Ky informacion nuk ju identifikon personalisht.

### Transferimet ndërkombëtare të të dhënave

Ne nuk i transferojmë të dhënat tuaja jashtë vendit, të dhënat ruhen në Shqipëri dhe në cilindo treg vendor ku jeni klient.

### Për sa kohë i ruajmë të dhënat tuaja personale

Ne do ta ruajmë dhe përpunojmë informacionin tuaj për aq kohë sa duhet me ligj ose për aq kohë sa na duhet që të jemi në gjendje t'ju ofrojmë shërbimet që keni kërkuar. Të dhënat që mbledhim për rekomandimet, analitikën dhe suportin tuaj ruhen për 6 muaj.

Ne do të mbajmë disa informacione personale për një periudhë të arsyeshme pasi kontrata juaj me ne të ketë përfunduar në rast se vendosni të përdorni sërish shërbimet tona. Ne, ose një nga partnerët tanë, mund t'ju kontaktojmë për shërbimet e Vodafone gjatë kësaj kohe nëse nuk keni hequr dorë nga marrja e komunikimeve tona të marketing-ut. Pasi këto baza të kenë skaduar, ne do ta fshijmë atë informacion.

### Masat e sigurisë në lidhje me të dhënat tuaja personale

Ne kemi ekipe të specializuara sigurie që shqyrtojnë dhe përmirësojnë vazhdimisht masat tona për të mbrojtur informacionin tuaj personal nga aksesit e paautorizuar, humbja aksidentale, zbulimi ose shkatërrimi.

Komunikimet në internet (të tilla si emaillet) nuk janë të sigurta nëse nuk janë të koduara.

Ne nuk mund të pranojmë përgjegjësi për çdo akses të paautorizuar ose humbje të informacionit personal që është jashtë kontrollit tonë.

Ne kurrë nuk do të kërkojmë informacionin tuaj të sigurt personal ose të llogarisë suaj me një mjet komunikimi të pakërkuar. Ju jeni përgjegjës për sigurinë e informacionit tuaj personal dhe të llogarisë dhe mos ndarjen e tyre me të tjerët.

Faqja jonë e internetit mund të ofrojë lidhje me faqet e internetit të palëve të treta. Ne nuk mund të jemi përgjegjës për sigurinë dhe përmbajtjen e faqeve të tilla të internetit të palëve të treta. Prandaj, sigurohuni që të lexoni politikat e privatësisë dhe të cookies të asaj kompanie përpara se të përdorni ose vendosni informacionin tuaj personal në faqen e tyre.

E njëjta gjë vlen për çdo faqe interneti ose përmbajtje të palëve të treta me të cilat lidheni duke përdorur produktet dhe shërbimet tona.

Ju mund të zgjidhni të përhapni informacionin tuaj në mënyra të caktuara, si p.sh. social plug-ins (përfshirë ato të ofruara nga Google, Facebook, Twitter dhe Pinterest) ose duke përdorur shërbime të palëve të treta që ju lejojnë të postoni komente ose informacione të tjera publikisht, dhe një palë të tretë mund ta përdorë atë informacion.

Social plug-ins dhe aplikacionet sociale operohen nga vetë rrjeti social dhe u nënshtrohen kushteve të tyre të përdorimit dhe politikave të privatësisë dhe të cookies. Duhet të siguroheni që jeni njohur me këto.

## Të drejtat tuaja

Më poshtë kemi dhënë detaje se si mund të ushtroni të drejtat tuaja. Nëse keni një pyetje ose nuk mund ta gjeni përgjigjen, ju lutemi kontaktoni ekipin tonë të Shërbimit të Kujdesit ndaj Klientit në [nakontaktoni@vodafone.com](mailto:nakontaktoni@vodafone.com).

### E drejta për të korrigjuar të dhënat personale

Në rast se informoheni që të dhënat tuaja nuk janë të sakta, ju keni të drejtë të kërkonti korrigjimin e tyre.

### E drejta për akses në të dhënat personale

Keni të drejtë të kërkonti në çdo kohë informacion mbi të dhënat tuaja personale që zotërohen nga Vodafone si dhe të kërkonti një kopje të të dhënave që përpunohen;

### E drejta për transferueshmërinë e të dhënave

Ju keni të drejtë të kërkonti që të transferojmë të dhënat tuaja në një kompani tjetër.

### E drejta për të kundërshtuar përdorimin e të dhënave personale

Ju keni të drejtë, në rrethana të caktuara, të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja personale;

### E drejta e fshirjes

Qëllimi i Vodafone është të përpunojë dhe ruajë të dhënat tuaja vetëm për aq kohë sa na nevojiten. Në rrethana të caktuara, ju keni të drejtë të kërkonti që ne të fshijmë të dhënat tuaja personale që disponojmë. Nëse besoni se të dhënat tuaja personale janë mbledhur dhe përpunuar në kundërshtim me ligjin, ju keni të drejtë të kërkonti fshirjen e tyre si dhe ndalimin e menjëhershëm të përpunimit.

### Si mund të ankoheni

Nëse dëshironi të na kontaktoni për ndonjë nga të drejtat tuaja ose nëse mendoni se ju janë shkelur të drejtat, liritë ose interes e ligjshme për të dhënat personale, kontaktoni ekipin tonë të Shërbimit të Kujdesit ndaj Klientit në [nakontaktoni@vodafone.com](mailto:nakontaktoni@vodafone.com).

Në rast pakënaqësie nga trajtimi i kërkesave nga ana e Vodafone ju keni të drejtë gjithmonë t'i drejtoheni Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në adresën Rr. "Abdi Toptani", nd. 5, Tiranë. Për më tepër informacion vizitoni faqen web të Komisionerit [www.idp.al](http://www.idp.al).